

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN!

BARKODI



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - VLADA – GOVERNMENT  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE  
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE

**OLIMPIADA E PËRBASHKËT E GJUHËS SHQIPE  
PËR KLASËN E NËNTË**

Faza e tretë

9 maj 2026

Udhëzime për nxënësin

Testi përmban gjithsej 50 pikë.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6a
Pikët						
Pyetja	6b	7	8	9	10	11
Pikët						
Pyetja	12	13	14	15	16	17
Pikët						
Pyetja	18	19	20	21	22	23
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

## PJESA I

### Reflektim mbi një protestë

*Lexoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.*

Dje në protestë, ndërsa e shikoja djalin tim me flamur në dorë, m'u kthyen para syve pamjet e para 30 viteve. Sikur koha të mos kishte lëvizur fare. Sikur brezat vetëm të ndërroheshin, por plagët të mbeteshin po aty. Në sytë e tij, në qëndrimin e tij, në atë flamur që e mbante me krenari, pashë veten dikur, me të njëjtin mall, me të njëjtin zemërim dhe me të njëjtën dhimbje.

Dhe aty, mes asaj turme, më goditi një ndjenjë e rëndë se sa e padurueshme është bërë kjo përsëritje. Sa e rëndë është të kuptosh se pas tri dekadash, djali yt po del në rrugë për ato gjëra për të cilat ke menduar se nuk do të duhej të dilte më askush. Për gjuhën. Për flamurin. Për dinjitetin. Për të drejtat elementare që në një shtet normal nuk kërkohen, nuk negociohen dhe nuk vihen në pikëpyetje sa herë që dikujt i zgjohet urrejtja ndaj shqiptarit.

Kjo është ajo që më dhemb më shumë. Jo vetëm padrejtësia e sotme, por fakti se ajo po u trashëgohet fëmijëve tanë si një barrë e vjetër. Dhe sinqerisht, kjo është bërë e padurueshme. Sepse kam jetuar gjithë jetën duke parë të njëjtat sulme ndaj shqipes, të njëjtat mllafe ndaj flamurit shqiptar, të njëjtat përpjekje për t'i bërë shqiptarët të ndihen mysafirë në vend të tyre. Dhe sot, në vitin 2026, ende ka njerëz që mendojnë se duke urreyer gjuhën time, flamurin tim dhe të drejtat e mia, po mbrojnë diçka të vetën. Jo! Ata vetëm po dëshmojnë sa të vegjël janë në mendje dhe sa të varfër janë në shpirt.

Më dhemb sepse dje, duke e parë djalin tim në protestë, e kuptova se ky shtet ende nuk ka gjetur forcë morale për t'u çliruar nga sëmundjet e vjetra. Problemet e njëjta po riciklohen, padrejtësitë e njëjta po përsëriten, ndërsa neve na kërkohet prapë durim, prapë heshtje, prapë mirëkuptim. Por ka një pikë, një moment, kur njeriu nuk ka më çfarë të durojë. Ka një pikë kur lodhja bëhet revoltë.

Unë nuk dua që nesër edhe nipat e mi të dalin në rrugë për të njëjtat halle. Nuk dua që edhe ata të rriten me ndjenjën se gjuha e tyre duhet mbrojtur vazhdimisht, se flamuri i tyre duhet arsyetuar, se identiteti i tyre duhet justifikuar para atyre që ende ushqehen me urrejtje primitive. Nuk dua që edhe një brez tjetër të trashëgojë të njëjtin ankth, të njëjtën pasiguri dhe të njëjtën betejë për gjëra që duhej të ishin mbyllur moti.

Prandaj po e them hapur se, me ata që e urrejnë shqipen, me ata që e urrejnë flamurin shqiptar dhe me ata që i sulmojnë të drejtat tona, unë nuk dua të kem as afërsi, as mirëkuptim, as komunikim. Nuk mund të kem respekt për dikë që e sheh identitetin tim si problem, kur unë nuk kam problem me identitetin e tij. Nuk mund të kem urë bashkëpunimi me ata që ende jetojnë me mendësinë e mohimit dhe të përbuzjes së tjetrit.

Kjo rrugë nuk do t'i sjellë asgjë të mirë askujt. As neve, as atyre që sot mendojnë se kanë pak forcë në anën e tyre. Historia ka treguar qartë ku çojnë urrejtja dhe mohimi i tjetrit, në ndarje, në tragjedi, në turp dhe në funde të rënda.

Të mençurit mësojnë nga gabimet e huaja. Budallenjtë as nga gabimet e veta.

*Mbi protestën e studentëve të Maqedonisë së Veriut për gjuhën shqipe.  
Lirim Dullovi, gazetar në të përditshmen "Koha".*

1. Kur autori shprehet "sikur koha të mos kishte lëvizur fare", nënkupton se: 1 pikë
  - A) problemet kanë mbetur të njëjta.
  - B) koha nuk ka sjellë gjë të re në atë qytet.
  - C) kërkesat e të rinjve nuk kanë ndryshuar.
  - D) gjuha shqipe ka mbetur po ajo që ka qenë.
  
2. Shqetësimi më i madh për autorin është: 1 pikë
  - A) historia që përsëritet nga njëri brez te tjetri.
  - B) pjesëmarrja e të birit në protestë.
  - C) pranimi i identitetit të të tjerëve.
  - D) indiferentizmi i të rinjve.

3. Autori shprehet se në një shtet normal të drejtat elementare nuk kërkohen, nuk negocohen, pasi ato janë: **1 pikë**

- A) të padiskutueshme dhe të garantuara me ligj.
- B) të kontestueshme në situata të pazakonta.
- C) në ndryshim, sipas interesave të shtetit.
- D) objekt diskutimi për pakicat kombëtare.

4. Cili është mesazhi i përcjellë në fund të tekstit? **1 pikë**

- A) E kaluara duhet hedhur pas.
- B) **Historia është mësim për të tashmen.**
- C) Protesta është zgjidhja e çdo problemi.
- D) Urrejtja është shtysë për të ecur përpara.

5. Si ndihet autori kur sheh djalin e tij në protestë? Çfarë e shkakton këtë ndjenjë? **2 pikë**

**Përgjigje:**

Autori ndien trishtim kur sheh të birin në protestë. Kjo vjen nga përsëritja e historisë, pasi arsyet për të cilat po proteston i biri janë të njëjta me ato të tijat para 30 vjetëve.

6. Autori përmend disa sëmundje të vjetra.

- a) Cilat janë ato? **3 pikë**
- b) Si mund të shërohen këto sëmundje? **1 pikë**

**Përgjigje:**

- a) Sulmet ndaj shqipes; mllfet ndaj flamurit, diskriminimi ndaj shqiptarëve.
- b) Ato mund të shërohen nëse respektohen të drejtat, liritë dhe dinjiteti i shqiptarëve.

7. Sinonimi i fjalës *mllëf* është: **1 pikë**

- A) pakënaqësi.
- B) padrejtësi.
- C) urrejtje.
- D) **duf.**

8. Fjala *pak* në fjalinë: “*Kanë pak forcë në anën e tyre.*”, është: **1 pikë**

- A) pjesëz.
- B) ndajfolje sasive.
- C) ndajfolje mënyre.
- D) **përemër i pacaktuar.**

9. Funkcioni sintaksor i formës së pashtjelluar në fjalinë: “*Ky shtet ende nuk ka gjetur forcë morale për t’u çliruar nga sëmundjet e vjetra*”, është: **1 pikë**

- A) **përcaktor me bashkim.**
- B) rrethnor mënyre.
- C) rrethnor qëllimi.
- D) kallëzues foljor.

10. Cila është rrënja e fjalës *padrejtësia*? **1 pikë**

**Përgjigje:** drejt

11. Fjalja: "Ka një pikë kur lodhja bëhet revoltë", është e përbërë me:

1 pikë

- A) nënrenditje kohore.
- B) nënrenditje përcaktore.**
- C) bashkërenditje përmbyllëse.
- D) bashkërenditje kundërshtore.

12. Ç'illoj mohimi është përdorur në fjalinë: "Kjo rrugë nuk do t'i sjellë asgjë të mirë askujt."? Nisur nga konteksti ku është përdorur, shpjegoni funksionin e këtij mohimi.

3 pikë

**Përgjigje:**

Mohim i plotë, i përbërë. Përdorimi i tri mohimeve shmang çdo mundësi apo alternativë tjetër, nuk bën asnjë përjashtim duke mos lënë asnjë shteg, asnjë përfitues. Ajo që shprehet në fjali nuk është thjesht një konstatim, por një situatë pa fitues. Kjo deklaratë kategorike thekson se nëse ndiqet kjo rrugë, nuk ka fitimtarë, por vetëm humbës.

13. Në cilën vetë është ndërtuar teksti? Si ndikon kjo në raport me lexuesin?

2 pikë

**Përgjigje:**

Teksti është ndërtuar në vetën e parë. Kjo vetë e bën komunikimin të drejtpërdrejtë dhe përjetimin e ngjarjeve më të besueshëm.

14. Përshkruani me një paragraf vështirësitë me të cilat është ndeshur gjuha shqipe gjatë kohërave.

3 pikë

**Kriteret e vlerësimit të paragrafit**

**Koherenca dhe lidhja me temën - 1 pikë:**

Paragrafi duhet të lidhet qartë me temën e dhënë. Duhet të jetë e qartë që nxënësi ka kuptuar thelbin e kërkesës dhe ka arritur të krijojë një lidhje të natyrshme midis vështirësive që ka hasur gjuha shqipe në historinë e saj dhe mënyrës si i ka përballuar këto sfida.

**Përdorimi i gjuhës së figurshme - 1 pikë:**

Nxënësi duhet të përdorë gjuhë të figurshme, si metafora, krahasime, dhe personifikime. Kjo do të tregojë aftësinë për të ndikuar te lexuesi dhe është një nga kërkesat e domosdoshme të një paragrafi përshkruar.

**Strukturimi i qartë i mbylljes - 1 pikë:**

Mbyllja duhet të jetë e qartë dhe e strukturuar mirë. Ajo duhet të përmbledhë detajet kryesore të tekstit dhe të lërë një përshtypje te lexuesi përmes një përfundimi të fuqishëm dhe të menduar mirë.

## **PJESA II**

15. Kongresi i Manastirit njihet si Kongresi i Alfabetit. Cilat janë alfabetet e miratuara prej tij? Jepni dy arsye pse mbeti në përdorim alfabeti që kemi sot.

4 pikë

**Përgjigje:**

*Alfabetet e miratuara:*

Kongresi i Manastirit miratoi përdorimin e dy alfabeteve: Alfabeti i Stambollit (i hartuar nga Sami Frashëri) dhe alfabeti i shoqërisë letrare Bashkimi të Shkodrës.

*Dy arsye:*

- Ofroi një zgjidhje praktike për shkrimin e shqipes, ndryshe nga rafinimet e Alfabetit të Stambollit.
- Me shkëputjen nga perandoria Osmane, për arsye ekonomike dhe praktike, botimet u orientuan drejt perëndimit

**PJESA III**

**Fatos Arapi "Deti"**

*Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.*

I vogël, me pantallona të, shkurtra,  
me këmbë të zbathura e një këmishë humaije,  
që e qepte vetë gjyshja...  
Ashtu darkë për darkë dilja në breg.  
Ndër gishtërinjtë e këmbës së ftohtë më rridhte rëra.

Unë prisja me orë të tëra,  
gjersa përnjëherësh, tutje nëpër fushat e gjëra të natës  
ngriheshin kope të çuditshme, të panumërta kuajsh të bardhë.  
Nëpër hapësirat e pafundme suleshin aradhë - aradhë.

Turfullonin.  
Binin me këmbë të thyera,  
rrokulliseshin duke gulçuar nëpër të zezat humnera.

Mbi ta fluturonin të tjerë.  
Jelet e hakërruara dallgë - dallgë fushën e qiellit fshihnin.  
Hingëllima të frikshme para tyre bridhnin.  
Ata vinin, afroheshin drejt meje.  
Gjokset e mëdhenj e të bardhë  
kreshpëronin përpjetë; këmbët e para rrihnin  
në erë...

Sytë u flakëronin.  
Një çast... dhe nën thundrat e tyre do të më copëtonin.  
Kur ja, me poterë  
si një gjëmim i madhërishtëm përplaseshin  
te këmbët e mia. Nga flegrat gjigante  
miliarda grimcëza të kristalta shfrynin  
për të fundit herë.

Të tjerë  
hingëllinin nëpër fushën e gjerë të natës.  
Me gëzim e frikë, orë të tëra unë, shihja  
kuajt bardhë

të suleshin nëpër furtunë.  
Thyenin këmbët, rrokulliseshin,  
që të vinin sa më parë tek unë  
shkelnin, fluturonin njëri mbi tjetrin...

Dhe tani, kudo që jam,  
ashtu fantastik e i madhërishtëm, më ndjek pas  
deti...

16. Pamja e detit i ngjall fëmijës: 1 pikë

- A) frikë dhe admirim.**  
 B) qetësi dhe trishtim.  
 C) brengë dhe pikëllim.  
 D) entuziazëm dhe hare.

17. Figura stilistike në vargun: "Nga flegrat gjigante - miliarda grimcëza të kristalta", është: 1 pikë

- A) krahasimi.  
 B) antiteza.  
**C) hiperbola.**  
 D) metonimia.

18. Motivi kryesor i poezisë është: 1 pikë

- A) kujtimi i fëmijërisë.**  
 B) udhëtimi i parë.  
 C) jeta në fshat.  
 D) lufta për liri.

19. Gjeni llojin e figurës stilistike që krijon grupi emëror "kuajt e bardhë" dhe shpjegoni përdorimin e saj në poezi. 3 pikë

**Përgjigje:**

*Lloji i figurës stilistike: Metafora.*

*Përdorimi i saj në poezi: Metafora "kuajt e bardhë" përfaqëson dallgët e detit. Ajo i jep natyrës një përftyrim të gjallë dhe dramatik. Përmes kësaj figure, deti shndërrohet në një forcë të egër dhe të pakontrollueshme, sa i bukur aq edhe i frikshëm.*

20. Si e përshkruan poeti marrëdhënien e fëmijës me detin? Ilustroni mendimin tuaj me vargje nga poezia. 2 pikë

**Përgjigje:**

**Përshkrimi:** Fëmija përjeton një ndjenjë të dyfishtë: frikë dhe magjepsje. Ai e sheh detin si diçka kërcënuese, por njëkohësisht nuk largohet dot prej tij. Kjo marrëdhënie është një përzierje respekti, frike dhe admirimi.

**Ilustrimi:**

Me gëzim e frikë, orë të tëra unë, shihja  
 kuajt bardhë  
 të suleshin nëpër furtunë.

21. Interpretoni fundin e poezisë. Si e lidh poeti të shkuarën me të tashmen? 2 pikë

**Përgjigje:**

Kujtesa është elementi që lidh të kaluarën me të tashmen. Përvoja e fëmijërisë nuk mbetet thjesht një kujtim, por bëhet pjesë e të tashmes për poetin. Deti e "ndjek pas", duke sjellë ndikimin e përhershëm të kësaj përvoje.

22. Dalloni tri arsye pse autori përmend detaje, si "pantallona të shkurtra" dhe "këmishë humaije". 3 pikë

**Përgjigje:**

- Detajet krijojnë pamje konkrete dhe realiste nga fëmijëria.
- Theksojnë pafajësinë e moshës, i veshur thjesht, i zbathur.
- Përforcojnë lidhjen emocionale me familjen dhe kujtimet nëpërmjet figurës së gjyshes.

## **PJESA IV**

23. Deti në poezi nuk është vetëm një element i natyrës, por një përvojë e thellë shpirtërore që e ndjek poetin gjithë jetën. Përshkruani në formën e një eseje një përvojë të tillë nga fëmijëria juaj që ju ka mbetur në kujtesë. **10 pikë**

### **Kriteret e vlerësimit të esesë përshkruese.**

#### **Shtjellimi i idesë:**

**3 pikë**

Shkruan një ese, e cila mbështetet në përvojën personale të nxënësit.

Shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat kanë ndikuar në jetën e tij.

Shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën.

Sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara.

Zbërthen bërthamën e temës së dhënë.

#### **Struktura dhe organizimi:**

**2 pikë**

Përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje.

Siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues.

Grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme.

Zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme.

Përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

#### **Stili dhe origjinaliteti:**

**3 pikë**

Përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën.

Përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit.

Përdor gjuhë subjektive që gërshetohet me detaje përshkruese.

Përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

#### **Larmia sintaksore dhe saktësia gjuhësore**

**2 pikë**

Përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë.

Shkruan pa gabime si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive.

Përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.